

# QENDRA E STUDIMEVE DHE PUBLIKIMEVE PËR ARBËRESHËT



Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave për krijimin e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët nr. 601, datë 04.09.2019 si dhe Ligjit nr. 7961, datë 12. 7. 1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, QSPA do të shpallë në faqen zyrtare të internetit konkursin për pozicionin:

## PASQYRA E PUNËS

<b>POZICIONI I PUNËS</b>	<b>Drejtor i Drejtorisë së Studimeve dhe Publikimeve</b>
<b>DEPARTAMENTI</b>	<b>Drejtoria e Studimeve dhe Publikimeve</b>
<b>ADRESA E QSPA</b>	<b>Rruga “Ibrahim Rugova”, Sky Tower, nr. 7/4, Tiranë</b>
<b>RAPORTON TEK</b>	<b>Drejtori Ekzekutiv</b>

## PËRSHKRIMI I PUNËS (DREJTORIA E STUDIMEVE DHE PUBLIKIMEVE)

Objekti i punës së Drejtorisë së Studimeve dhe Publikimeve është:

- Konceptimi, organizimi dhe realizimi i kërkimeve dhe studimeve të thelluara në lëmitë e ndryshme të spektrit arbëresh;
- Organizimi i botimeve të parashikuara për një vit kalendarik;
- Zhvillimi i projekteve që hyjnë në fushën e veprimit të QSPA-së, duke mobilizuar e bashkërenduar burime njerëzore dhe materiale brenda dhe jashtë QSPA-së;
- Nxitja e këtyre kërkimeve nëpërmjet organizimit të seminareve, konferencave, takimeve, apo eventeve;
- Valorizimi i rezultatit të këtyre aktiviteteve nëpërmjet publikimeve dhe akteve të tjera njohëse dhe promovuese.

## DETYRAT DHE PËRGGJEGJËSITË E DREJTORIT TË DREJTORISË SË STUDIMEVE DHE PUBLIKIMEVE PËR ARBËRESHËT

- Të ketë profil studiuesi të historisë, parapëlqehet specialiteti i historisë së Mesjetës me prekje historinë e Arbëreshëve;
- Të ketë kryer studime në fushën e tij/saj të specialitetit, e cila është një nga disiplinat, apo një kombinim i disiplinave të shkencave humanistike të aplikuara mbi komunitetet arbëreshe;
- Të ketë aftësi manaxheriale drejtuese, të monitorojë dhe bashkërendojë punën midis sektorëve të qendrës, brenda e jashtë saj;
- Të koordinojë dhe integrojë hartimin e planeve institucionale në plan afatgjatë në bashkëpunim me Drejtorin Ekzekutiv të Qendrës dhe me stafin e studiuesve;
- Të shkruajë dhe publikojë në suportet e QSPA-së, si faqja web dhe suporte të tjera të komunikimit elektronik, botimet e QSPA-së, aktivitetet, shtypin periodik të QSPA-së, etj;
- Të marrë pjesë në organizimin e konferencave dhe seminareve shkencore, të cilat i mbështet me ide, përmbajtje dhe organizim;
- Të jetë i aftë të realizojë, një apo disa nga aktivitetet që hyjnë në objektin e punës së Drejtorisë së Studimeve dhe Publikimeve, të cilat do t'i caktohen nga eprorët sipas nevojave të kalendarit të veprimtarive;
- Të përgatisë informacione periodike në lidhje me realizimin e aktiviteteve të planëzuara dhe t'i paraqesë ato tek Drejtori Ekzekutiv.

## EDUKIMI DHE TRAINIMET

### Edukimi dhe eksperiencia që kërkojmë:

- Të zotërojë titullin “Doktor” në fushën e Historisë (Parapëlqehet të jetë specialist i mesjetës dhe në veçanti i studimeve mbi arbëreshët);
- Të ketë të paktën 7 vite përvojë pune në fushën për të cilën punësohet;
- Të ketë aktivitet kërkimor-shkencor dhe botime në disiplinën përkatëse;
- Të përmbushë kriteret e punësimit që përcaktohen nga aktet ligjore dhe nën-ligjore në fuqi;
- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të jetë i certifikuar në gjuhë të huaj , minimumi niveli C1 (Italisht dhe Anglisht).

### AFTËSITË

- Aftësi drejtuese, koordinuese, interpretuese, vendimmarrëse;
- Aftësi pune në grup;
- Aftësi komunikuese shumë të mira;
- Aftësi të mira në përballimin e punës nën presion.

### KUSHTET E PUNËS

#### MJEDISI I PUNËS

Mjedisi i punës, karakterizohet nga ambientet e përshtatshme dhe të mirë organizuara për punën kërkimore e studimore.

#### ORARI I PUNËS

Nga e hëna në të enjte, orari është nga ora 08:00 deri në orën 16.30.  
Ditën e premte, orari është nga ora 08:00 deri në orën 14:00.

**Kandidatët që aplikojnë, duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:**

1. **Kërkesë me shkrim ku shpreh interesin për të aplikuar për pozicionin e punës.**
2. **Jetëshkrim (CV) në formatin EuroPass.**
3. **Fotokopje të diplomave universitare dhe të titullit “Doktor”**
4. **Referencë nga të paktën një profesor**
5. **Fotokopje të librezës së punës ose vërtetime nga punëdhënësit, të cilat vërtetojnë eksperiencën në punë.**
6. **Kopje të artikujve, teksteve, revista, projekte shkencore etj.**
7. **Certifikata që vërtetojnë zotërimin e gjuhës së huaj.**

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve të bëhet brenda datës 12/10/2020 ora 12:00, në Zyrën e Protokollit të QSPA-së në rrugën “Ibrahim Rugova”, pallatit “Sky Tower”, kati i shtatë, ap. 4, si dhe në adresën e e-mail: info@qspa.gov.al

**Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësitë të cilat do të zhvillohet intervista:**

- Njohuri mbi ligjin nr. 80/2015 datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.
- Njohuri të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për fushën e mësimdhënies në institucionet e arsimit të lartë.

**Mënyra e vlerësimit të kandidatëve.**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv.

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

**Data e daljes së rezultateve të konkurrimit dhe mënyra e konkurrimit**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) do të shpallë fituesin faqen zyrtare të institucionit.

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga QSPA-ja, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail)